



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri

Press and Public Information Office
Zyra e Shtypit dhe e Informimit Publik

Transkript i takimit të Kreut të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadorit Osmo Lipponen, me median, 18 qershor 2004

Faleminderit dhe mirëserdhët edhe nga ana ime. Ne kishim menduar të kishim një mbulim të gjerë të emërimit tim në detyrën e re dhe të nxirrnim një deklaratë për shtyp të menduar mirë. Por duket sikur informacioni ka rrjedhur me një shpejtësi të tillë, sa një pjesë e medias e kishte marrë këtë informacion brenda 15 minutash nga momenti kur unë ua bëra të ditur njerëzve të mi dhe mendoj se është normale që të njoftosh në fillim njerëzit e tu. Por, meqenëse një pjesë e medias përsëri ishte ndjerë e lirë që të shtonte interpretimet dhe hamendësimet e veta, pse u emërova, pse po largohem, në vend që të lëshonim një deklaratë për shtyp, mendova se do të ishte më mirë që të përballohesha me ju të gjithë. Në fillim, do të them diçka për emërimin tim dhe kohën kur ndodh. Ne kemi pasur një numër të madh emërimesh në Shërbimin Diplomatik Finlandez, por një pjesë e tyre ndodhën më parë se ç'ishin planifikuar. Ka pasur disa dorëheqje në këtë shërbim dhe kjo shpjegon pjesërisht kohën e emërimit tim. Pastaj, ky post është një prej më të kërkuarve në Shërbimin Diplomatik Finlandez dhe, meqenëse, i sjell disa leverdi të tjera jetës sime personale – për shembull, gruaja ime është amerikane – është një situatë ideale. Tani jam gati t'u përgjigjem pyetjeve tuaja.

Shijak Televizion: Z. Ambasador, a ishte qëndrimi juaj në Shqipëri i vështirë, duke pasur parasysh kritikën e një pjese të politikës ndaj jush?

Ambasadori Lipponen: Kjo është në një farë mënyre një pyetje personale. Mua më pëlqejnë sfidat. Siç thotë një prej sloganeve që unë përdor, *s'ka fitore pa mundim*. Unë nuk i marr këto goditje si inat personal. Ato janë pjesë e politikës suaj të brendshme dhe unë e kuptoj shumë mirë se, nëse unë jam një kurban apo shenjstër e përshtatshme dhe nëse kjo i shërben një qëllimi të mirë, unë buzëqesh dhe e marr goditjen.

Albania: Me kë arritët që të punoni dhe bashkëpunoni më lehtë? Me kryetarin e maxhorancës apo të opozitës?

Ambasadori Lipponen: Nuk është ende koha për të komentuar për këtë, sepse, siç i thashë edhe stafit tim, ky nuk është fundi. Dhe, ndryshe nga ç'e ka interpretuar një pjesë e medias, projektet kryesore me të cilat ne po merremi nuk kanë dështuar. Ne po punojmë shumë, po negociojmë, gjërat po lëvizin, edhe pse ngadalë. Ka të ngjarë që ligji i pronave

të kthehet përsëri në Parlament – ne patëm dje disa diskutime – ka pasur kompromis të gjerë për çështjet zgjedhore. Ne e kemi bërë punën tonë në këtë fazë dhe po presim fillimin e fazës tjetër. Tani u takon partive që ta mbajnë fjalën, por unë besoj se, në një të ardhme të afërt, Parlamenti do të fillojë t'i diskutojë çështjet zgjedhore dhe ne jemi gati që të ofrojmë ndihmesën tonë në këto diskutime. Me kthimin e pronave, ne i kemi dhënë gjithë kohën kontributin tonë parlamentit dhe, nëse do të ketë nevojë përsëri për ne, ne jemi këtu, por, para së gjithash, ne jemi duke ndërtuar gatishmërinë për të mbështetur zbatimin e ligjit. Konsensusi kryesor për kthimin e pronave dhe çështjeve zgjedhore, në fakt, ekziston. Ka pasur shpjegime të ndryshme lidhur me kuptimin e fjalës *konsensus*. Kjo fjalë nuk do të thotë 100%, por, le të themi, shumica e gjerë.

Televizioni Arbëria: Është e vërtetë që ka një letër kritike që është dërguar në Vjenë nga autoritetet shqiptare lidhur me një kontradiktë me ligjin për kthimin e pronave, përveç debatit publik që ju keni pasur me z. Ruçi? Çfarë diskutuat dje me z. Hajdaraga?

Ambasadori Lipponen: Unë nuk kam dijeni për ndonjë letër dhe, edhe nëse do të ekzistonte, kjo s'do të kishte rëndësi. Shumica e gjerë ka dhënë mbështetje të plotë për punën tonë. Në fillim të diskutimeve për draftin përfundimtar, pati një konsensus të gjerë dhe ajo që është më e rëndësishme, kur drafti doli nga grupi i ekspertëve i kryesuar nga ne, ai përmbante 12 firma, me sa mbaj mend. Pra, i kujt është faji? Edhe një herë, Prezenca e OSBE-së bëri një punë shumë të mirë, por ne nuk jemi Parlamenti, ne vetëm e ndihmojmë Parlamentin me ftesën e tij. Të gjitha vendimet merren nga Parlamenti dhe jo nga ne. Pra, e kujt është përgjegjësia?

Zëri i Amerikës: Ju përmendët më parë se ligji për kthimin e pronave mund të kthehet në Parlament për rishqyrtim. Kjo është ajo që parandjeni që do të ndodhë, apo ajo që mendoni se duhet të ndodhë, duke pasur parasysh kritikën ndaj këtij ligji për mosrespektim të parimeve themelore?

Ju po bëni përgjithësime tepër të gjera lidhur me këto parime bazë. Ka vetëm nja dy paragrafe në ligjin përfundimtar që janë të diskutueshme. Ligji, në përgjithësi, është i mirë, por, në mënyrë që ky ligj i mirë të zbatohet dhe të respektohet siç duhet, ai duhet të përmbushë disa kërkesa. Dhe një prej parimeve kryesore është se brenda ligjit nuk duhet të ketë kontradika, ndërsa në paragrafin e parë, me sa më kujtohet, thuhet se ky ligj nuk ndryshon ose nuk prek ligjet e përmendura në shtojcën numër një. Ligji i parë në këtë shtojcë është ai 7501 dhe, të paktën, ne dimë se Parlamenti e ndryshoi atë dhe i dha Komitetit Shtetëror kompetenca për të marrë vendime që mund ta ndryshojnë vendimet e marra në bazë të 7501-shit. Meqenëse kemi qenë partnerë në këtë proces, kemi kërkuar tekstin përfundimtar dhe, në një parlamentarizëm normal transparent, teksti duhet të ishte shpërndarë menjëherë. Projektligji duhej t'u ishte shpërndarë parlamentarëve përpara se të votohej në formë të shkruar dhe më duket normale që, meqenëse kemi kontribuar aq shumë, të na jepej një kopje e ligjit përfundimtar. Ne u detyruam ta lexonim atë në gazeta, por, kur ta marrim tekstin përfundimtar në rrugë normale, do të japim komente më të detajuara. Dua të përsëris edhe një herë se procesi në përgjithësi ishte shumë i mirë, kryesisht shumë konsensual, ndërsa, në fazën përfundimtare, disa gjëra ndoshta nuk shkuan siç duhej, veçanërisht, duke pasur parasysh faktin se, në fillim të diskutimit për

ligjin, pati konsensus të gjerë. Do të kishte qenë shumë mirë, nëse ky ligj do të kishte marrë konsensus të gjerë.

Nuk e kuptova, mendoni që ligji mund të kthehet apo duhet të kthehet në parlament?

Media ka thënë se Presidenti e ka kthyer atë tashmë, por kjo është diçka që është thënë vetëm nga media.

Pra, i referoheni vetëm asaj që thotë media?

Kjo duket se besohet edhe nga disa politikanë të rëndësishëm, pra, që Presidenti do ta kthejë atë, por nuk e di se ku e bazojnë këtë.

Televizioni Klan: Në çfarë fazë janë negociatat për reformën zgjedhore tani, meqë jeni kritikuar, gjithashtu, për fshehtësi konsultimesh që keni kryer me dy partitë kryesore? Kush e pengon reformën, PS-ja apo PD-ja?

Kjo kritikë më duket pak e çuditshme. Është normale që, në diplomaci dhe në politikë, para negociatave, duhet të studiosh ku e gjejnë veten lojtarët kryesorë. Dhe, nëse ndokush i ka kushtuar vëmendje rekomandimeve të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias dhe të gjitha deklaratave të OSBE/ODIHR-it, idea kryesore është se ne duhet të angazhohim dy partitë kryesore në kompromise dhe të sigurojmë mbështetjen e tyre për ndryshime të mundshme të Kodit Zgjedhor. Unë i kundërshtoj plotësisht këto lloj kërkesash joparlamentare që pakica në pakicë duhet të ketë të drejtën për të vendosur se si duhet të jete ligji. Realitetet parlamentare duhet të merren parasysh. Ne duhet ta arrijmë këtë lloj kompromisi, i cili garanton kushte optimale për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Dhe nëse asnjë prej partive kryesore nuk pranon me çfarëdolloj gjëje për të cilën bihet dakort, dhe nuk pranon të hyjë në procesin e negociimit, zgjedhjet mund të zhvillohen në një atmosferë ku mungesa e theksuar e besimit mund edhe të rritet. Pra, ne po bëjmë ekzaktësisht atë që një organizatë ndërkombëtare normale dhe një negociator diplomatik duhet të bëjë. Aktivitetet tona mbështeten edhe në pranimin dhe vullnetin e dy partive kryesore, dhe ky proces, kur të shkojë në fazën tjetër, do t'i përfshijë të gjithë. Asgjë nuk është vendosur kundër rregullave të parlamentarizmit. Meqenëse jam shumë pro parlamentarizmit, nuk më pëlqen që të njëjtët njerëz mbajnë qëndrimin që u shkon për shtat, duke i kërkuar bashkësisë ndërkombëtare që të vendosë në emër të parlamentit tuaj. Kundër këtyre dy partive të këqija, të cilat përbëjnë shumicën në Parlament, ose kur deklaratat e bashkësisë ndërkombëtare, le të themi, të organizatës sonë, nuk u pëlqejnë këtyre forcave, ato na tregojnë derën dhe thonë se dërgojnë letra poshtë e lart. Këto janë flluska sapuni. Dua t'i shoh këto letra dhe, nëse do të kishin ekzistuar, do t'i kisha parë. Unë kam mbështetjen e plotë nga të gjitha palët e nevojshme.

Kush e pengon reformën zgjedhore tani, PD-ja apo PS-ja?

Unë mendoj se të dyja partitë kanë vullnet politik. Megjithatë, besimi është ai që nevojitet, por përsëri mendoj se ai ekziston. S'më takon mua të përgjigjem në emër të tyre, por gjërat janë më mirë se sa duken.

Televizioni A1: A është largimi juaj i lidhur me dorëheqjen nga ana juaj, apo vetëm me detyrën e re?

Media e ka sajuar që kjo ishte një dorëheqje. Kjo nuk është një dorëheqje. Ky është një rotacion normal në sistemin finlandez. Ne ishim të përgatitur për të pasur një emërim maksimal deri në tre vjet, megjithëse praktika normale finlandeze është që të caktojë njerëz vetëm për dy vjet, por, siç thashë, rotacioni ndodhi pak më shpejt dhe unë mora një post me të vërtetë të mirë. Pra, duhet ta kini parasysh këtë, nga një post i mirë në një post tjetër të mirë. Ndryshe nga ç'ka pretenduar media apo një pjesë e saj, ajo që ka bërë Prezenca në pak më shumë se një vit e gjysmë është shumë mbresëlënëse. Nuk mendoj se kemi dështuar në ndonjë drejtim. Ne, me të vërtetë, i ndihmojmë partitë që të ecin në rrugën e duhur dhe, siç thashë, këto procese të rëndësishme kanë sjellë rezultate të mira.

Telenorba Shqiptare: Z. Ambasador, a mund të na thoni diçka më tepër lidhur me marrëdhëniet tuaja me institucionin e Presidentit? A ka pasur ndonjë përplasje midis jush për ligjin e kthimit të pronave?

Asgjë të tillë. Çështja e kthimit të pronave është detyrë e parlamentit dhe ekzekutivit. Ne jemi ftuar në këtë proces nga parlamenti. Ndonjëherë, ka pasur edhe diskutime me Presidentin, por ky nuk është, me sa kuptoj unë, një proces i Presidentit, nëse i kemi kuptuar drejt rolet e institucioneve. Dhe, siç kam thënë disa herë, ne bashkëpunojmë me këdo. Lidhur me kthimin e pronave, ne jemi përqëndruar në bashkëpunimin me Parlamentin.